



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 70 dt.30.04.1996

PER
NDERTIMIN NE TIRANE TE NJE MEMORIALI QE DO TE
PERKUJTOJE 22 VIKTIMAT E PAFAJSHME, TE AKUZUAR PA GJYQ
NEN AKUZEN E VENDOSJES SE NJE BOMBE NE GODINEN E
ATHERSHME TE AMBASADES SOVJETIKE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës për të ndërtuar në Tiranë një memorial siç cilësohet në emërtimin e këtij vendimi, mbështetur në ligjin e Pushtetit Lokal, Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.15.

VENDOSI

1. Të ngrihet në Tiranë memoriali në nderim të 22 viktimave të pafajshme që u arrestuan dhe u pushkatuan pa gjyq nën akuzën e vendosjes së një bombe në godinën e Ambasadës Sovjetike.
2. Drejtoritë e Kulturës së Urbanistikës të përcaktojnë një vend pranë qendrës dhe ta miratojnë në KRRT.
3. Drejtoria e Financës të përcaktojë dhe të likujdojë vlerën e të gjithë veprës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA